



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE
KABINETI

Adresa: Blvd. "Bajram Curri", Tirane-Shqiperi, tel/fax: +355 375137

Nr 4818 prot

Tirane me 5.12.2008

**UDHEZIM
Nr. 676, Date. 5.12.2008**

**PER SHKALLEN E PENALIZIMIT PER SHKELJET ADMINISTRATIVE TE
PARASHIKUARA NE LIGJIN NR 8025, DT.9/11/1995 “PER MBROJTJEN NGA
RREZATIMET” I NDRYSHUAR**

Në zbatim të Ligjit nr. 8025, dt.09.11.1995 “Për Mbrojtjen nga Rrezatimet” i ndryshuar

UDHEZOJ:

1-Ne cdo rast qe verehen shkelje te nenit 4 te Ligjit Nr.8025, dt. 09.11.1995 i ndryshuar (per paisjen me licence) subjekti penalizohet me gjobe ne vleren 300 000 lek.

2-Ushtrimi i profesionit kur shkelen rregullat e sigurise per pacientet, personelin dhe publikun ne lidhje me:

- a-Administrimin e sigurise se pajisjes, penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke
- b-Mbrojtjen e personelit, penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke
- c-Sistemin e sinjalizimit, penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke
- d-Veprime te sigurise teknike, penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke
- e-Klasifikimin e zonave, penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke
- f-Monitorimin personal dhe monitorimin e ambjentit, penalizohet ne vleren 120.000 leke
- g-Mungesa e Planit te Emergences, penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke
- h-Dokumentacionin ne lidhje me pajisjen, penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke
- i-Kalibrimin e paisjeve penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke
- j-Mosperdorimin e shenjave paralajmeruese ne vende te dukshme penalizohet me gjobe ne vleren 120.000 leke

3-Ne rastin kur lendet radioaktive qe perdoren nga subjekte te licensuara, nuk jane te siguruara fizikisht ne mqedise te ndertuara enkas per kete qellim , subjekti penalizohet me gjobe ne vleren 150.000 lek.

4-Ne rastet kur Inspektori i Zyres se Mbrojtjes nga Rrezatimet, si person i autorizuar per kontolle dhe inspektieme, pengohet te kryeje detyren e tij per t'u futur ne mqedise ku punohet me burime te rrezatimit jonizues me qellim kontrolli dhe inspektim (sipas nenit

10 te rregullores se KMR) subjekti qe kryen kete veprim penalizohet me gjobe me vleren 240.000 lek

5-Mos zbatimi i detyrave te lena nga ana e Inspektorit te ZMR per sigurimin dhe sigurine me burime te rezatimet jonizues ne afatin e caktuar penalizohet me gjobe ne vleren 40.000 lek.

6-Mos zbatimi i masave per transferimin e mbetjeve radioaktive ne vendin e autorizuar per trajtimin e mbetjeve ne fund te perdonimit te tyre sic eshte percaktuar ne marreveshjen paraprake penalizohet me gjobe ne vleren 100.000 lek.

7-Mos plotesimi ne kohe dhe ose mosrinovimi i licences penalizohet me gjobe ne vleren 10.000 leke per cdo muaj vonese.

8- Gjobat jane tarifa fikse , pagesa e te cilave behet ne numrat e llogarise ku kryhen veprimet e Zyres se Mbrojtjes nga Rezatimet.

9-Personat juridke e fizike jane te detyruar te bejene shlyerjen e gjobave sipas afateve te parcaktuara ne dokumentat perkates.Ne arst mos pagime Brenda 6 muajsh personit i hiqet licenca.

Minister i Shendetesise

Anila GODO